

VENDIM
Nr. 305, datë 23.10.2023

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS LIDHUR ME KËRKESËN E SHOQËRISË
“M.C. ENERGJI GOJAN” SHPK, PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA “HEC GOJAN”**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a” dhe 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 23.10.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2277/1 prot., datë 19.10.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘M.C. Energji Gojan’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC Gojan”,

konstatoi se:

- Shoqëria “M.C. Energji Gojan” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2277 prot., datë 12.10.2023, paraqiti aplikimin për pajisjen me licencë për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC “Gojan”, në pellgun ujëmbledhës të lumit “Fani i Madh”, në zonën e Gojan-Gjegjanit, qarku Shkodër, me kapacitet të instaluar 15 MW.

- Aplikuesi ka depozituar në ERE Kontratën e Koncesionit e formës BOT me nr. 2515 rep., nr. 1181 Kol., datë 6.11.2017, “Kontratë koncesionit e formës ‘BOT’ (ndërtim-operim-transferim) për objektin ‘Dhënie me koncesion të hidrocentralit Gojan’”, të nënshkruar mes Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues dhe subjektit për qëllime të veçanta “M.C. Energji Gojan” sh.p.k., në cilësinë e koncesionarit, e ndryshuar me kontratën shtesë të koncesionit nr. 2 rep., nr.2/3 kol., datë 3.1.2019 dhe me kontratën shtesë nr. 1990 rep., nr. 1465 kol., datë 7.12.2022.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar.

- Shoqëria ka plotësuar kapacitetin e instaluar të HEC-it prej 14,99 MW në formatin e aplikimit, por nga kontrata e koncesionit, si dhe lejet përkatëse (VNM dhe leja për përdorim të burimit ujqor), rezulton se kapaciteti i HEC “Gojan” është 15 MW, ndaj ERE-s do të marrë në konsideratë këtë kapacitet.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, rezulton se shoqëria “M.C. Energji Gojan” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të nenit 9 të rregullores, për pikën 1.1, gerrat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gerrat “a”, “b” dhe “d”, për pikën 2, germa “e”.

- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezulton se dokumentet janë depozituar në formatin fotokopje, ndaj në zbatim të përcaktimeve të nenit 8, pika 3 të rregullores, duhet të depozitohen në formatin origjinal ose fotokopje e njësuar me origjinalin dokumentet në vijim:

- plani i biznesit;
- kontrata e koncesionit me MIE-n, së bashku me dy amendimet e saj;
- shkresa e OST sh.a. për miratimin në parim të pikës së lidhjes;
- leja për përdorimin e burimit ujqor.

- Po ashtu, nga ky aplikim rezulton gjithashtu se nevojitet të plotësohet dokumentacioni/informacioni në vijim:

NENI 9

Formati dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1.2 Dokumentacioni juridik dhe administrativ

- *germa "c"*: të depozitohet në ERE struktura e shoqërisë, ku të jetë përfshirë stafi teknik, ose marrëveshjen/aktin e dakordësisë së ortakut të vetëm të saj të shoqërisë "M.C. Inerte" sh.p.k., për vënien në dispozicion të stafit të tij për mbarrëvajtjen e ushtrimit të veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike.

Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal

- *germa "a"*: të depozitohet në ERE vërtetimi që shoqëria nuk ka detyrime në lidhje me kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

- *germa "b"*: të depozitohet në ERE dokumentacioni përkatës që vërteton mbulimin nga ana financiare të vlerës totale të investimit të projektit.

Pika 2, Dokumentacioni specifik sipas tipit të licencës

- *germa "a"*: të bëhen saktësimet përkatëse në numrin e njësive gjeneruese dhe kapacitetit të instaluar të secilës, duke mbajtur në konsideratë që totali i kapacitetit të tyre nuk duhet të tejkalojë totalin e kapacitetit të instaluar të centralit të përcaktuar në kontratën e koncesionit. Po ashtu, subjekti duhet të plotësojë dhe vitin e ndërtimit të veprës, si dhe datën e fillimit të operimit.

- *germa "c"*: të depozitohet në ERE miratimi përfundimtar/marrëveshja e nënshkruar me OST sh.a. për miratimin e pikës së lidhjes me rrjetin e transmetimit dhe të bëhen sqarimet përkatëse pse ky miratim është për kapacitetin prej 15.3 MW, ndërkohë që në kontratën e koncesionit, VNM-në dhe lejen e përdorimit të burimit ujor kontatohet se kapaciteti i instaluar i HEC është 15 MW.

- Shoqëria në kuadër të vlefshmërisë së VNM-së paraprake, duhet të informojë ERE-n nëse ka filluar punimet për ndërtimin e centralit fotovoltai.

- Për dokumentacionin e plotësuar pjesërisht do të njoftohet aplikuesi që të bëjë plotësimin e tij brenda afatit të përcaktuar në "Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike" e ndryshuar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "M.C. Energji Gojan" sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Gojan", me kapacitet të instaluar 15 MW.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë "M.C. Energji Gojan" sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti